



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.6.1-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PEJËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa mund të ndërmerrë edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës së Pejës në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga Xhevat Seferi (Udhëheqës Ekipi) dhe Enver Ramadani (anëtar).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm .....	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	13
4 Qeverisja.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	32


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të komunës së Pejës për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 28/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Buxheti final për të hyrat vetjake ishte nënvlerësuar për 226,542€ dhe njëkohësisht është nënvlerësuar buxheti final për shpenzime për të njejtën shumë;

Në PVF nuk janë prezantuar Pagesat nga Palët e Treta në shumë 142,377€; dhe


Në shënimin 12 nuk janë shpalosur pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale në shumë 487,000€.


*Si theksimi i Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse në PVF nuk është e plotë dhe pagesat nga palët e treta në shumë prej 142,377 nuk ishin prezantuar në PVF..


**(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë:







### Përgjigjja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i komunës është pajtuar me të gjitha gjetjet tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari:

- Të diskutojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit janar/shkurt 2016 të inicojë diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të komunës së Pejës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:



**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzion i përgjithshëm

Komuna nuk ka arritur të adresojë çështjen e gabimit material në pasuritë e prezentuara në PVF. Përveç kësaj, PVF-të e komunës përmbajnë një numër të gabimeve financiare dhe mungesë të shpalosjeve të sakta dhe të plota. Andaj, 'Deklarata' e bërë nga Kryetari i komunës dhe ZKF, të cilës i jemi referuar më lartë, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në Qeveri, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet. Kjo mund të rezultojë me Modifikim të Opinionit të Auditimit.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Buxheti final për të hyrat vetjake ishte nënvlerësuar për 226,542€ dhe njëkohësisht është nënvlerësuar buxheti final për shpenzime për të njejtën shumë;

Në PVF nuk janë prezantuar Pagesat nga Palët e Treta në shumë 142,377€; dhe

Në shënimin 12 nuk janë shpalosur pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale në shumë 487,000€.

*Si theksimi i Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse në PVF nuk është e plotë dhe pagesat nga palët e treta në shumë prej 142,377 nuk ishin prezantuar në PVF.

**(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).**

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 28.10.2014, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Ky është një rrezik i anomalive materiale i cili mund të rezultojë me Theksim të Çështjes.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive të prezentuara në PVF

Ne shqyrtoam veprimet e menaxhmentit dhe udhëzimet e aplikuara në lidhje me regjistrimin e pasurive. Në Memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimet e nevojshme për të siguruar që pasuritë e prezentuara në PVF janë të plota. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse komisionet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive ishin formuar me vonesë dhe deri në kohën e auditimit nuk ishte arritur progres. Si pasojë e kësaj regjistri i pasurive dhe vlera e tyre e prezentuar në PVF nuk është e plotë.

**Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë** - Kryetari i komunës duhet të sigurojë një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive, duke përcaktuar rolet kyçe që në këtë proces mund të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke mbledhur dhe raportuar të gjitha të dhënat mbi pronat në posedim të komunës. Më pas, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim të pasurive të identifikuar dhe, pas rishikimit kritik nga ana e Kryetarit, një raport t'i dorëzohet zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Gjithashtu, komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohen çdo vit në kohë adekuate që të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese për PVF dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës vjetore); dhe
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim ato ishin përmbushur plotësisht, me përjashtim të Raportit të Performancës për vitin 2013, i cili nuk ishte përgatitur dhe publikuar, dhe një praktikë e tillë mund të përsëritet edhe për vitin 2014.

Përkundër korigjimit të disa gabimeve jo-materiale në draft PVF, PFV-të finale përmbajnë një numër gabimesh financiare siç shihet në vazhdim.

---

## Çështja 2 – Përgatitja e PVF – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Menaxhmenti nuk ka zbatuar një rishikim efektiv të procesit të përgatitjes së PVF-ve i cili ka rezultuar me gabime si në vijim:

- Në Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave nuk janë prezantuar pagesat nga palët e treta në shumë 142,377€;
- Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, buxheti final për të hyrat vetjake është nënvlerësuar për 226,542€ dhe njëkohësisht është nënvlerësuar buxheti final për shpenzime me 226,542€; Poashtu, buxheti final nga donacionet është mbivlerësuar për 1,300€;
- Numrat e shpalosjeve nuk janë të harmonizuar me numrat e shënimeve në pasqyrat e para;
- Në shënimin 12 nuk janë shpalosur pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale në shumë 487,000€;
- Në shënimin 30 (përmbledhja e pasurive kapitale) vlera e pasurive të komunës nuk është e plotë (shih çështjen 1); dhe
- Në shënimin 34, llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar për 87,893€.

Marrë parasysh këto që u thanë më lart, ‘Deklarata’ e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet jo e plotë dhe e pasaktë.

**Rreziku** Mungesa e një rishikimi efektiv të PVF-ve nga niveli i lartë i menaxhmentit ka rezultuar me gabime materiale të cilat mund të shpiejnë tek një opinion i modifikuar. Më tutje, PVF-të që përfshijnë gabime mund të konsiderohen si jo të besueshme, duke rezultuar kështu në dëmtim të kredibilitetit në raportimin financiar të komunës.

**Rekomandimi 2** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë një rishikim kritik nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar kontrollet e nevojshme.

---

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Pavarësisht përgatitjes së Planit të Veprimit për të adresuar rekomandimet e vitit 2013, një numër çështjesh të rëndësishme mbeten ende për t'u adresuar.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar me 18 rekomandime kryesore dhe komuna ka përkatitur një Plan Veprimi për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit për vitin 2014, vetëm gjashtë (6) rekomandime janë adresuar plotësisht, pesë (5) janë adresuar pjesërisht, dhe shtatë (7) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të vitit të kaluar nuk ishin adresuar. Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve të AP-së në pajtim me planin e përgatitur për veprim.

**Rreziku** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme në sistemet kyçe financiare, me theks të veçantë në:

- Regjistër të mangët të pasurive;
- Nivel të ulët të ekzekutimit, veçanërisht të investimeve kapitale;
- Dobësi të vazhdueshme në menaxhimin e të hyrave vetjake;
- Dobësi të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për paranë; dhe
- Përfitim të limituar nga auditimi i brendshëm.

**Rekomandimi 3** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AP për vitin 2014 dhe atyre të pa adresuara nga viti 2013, të përcaktoj në mënyrë specifike stafin përgjegjës, afatet kohore dhe aktivitetet e duhura për zbatimin e rekomandimeve. Fokus fillestar i këtij plani duhet të jenë çështjet e një rëndësie më të madhe. Progresit kundrejt planit duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Qeverisja e fortë mbështetë planifikimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve të komunës.

Aspektet kyçe që duhet adresuar për të mundësuar një kornizë të mirëfilltë qeverisëse janë:

- Menaxhimi i rrezikut ku komuna nuk ka avendosur procedura formale dhe të dokumentuara për minimizim të rrezikut ndaj objektivave operative dhe strategjike të komunës;
- Vetëvlerësimi ku komuna nuk i ka përmbushur kërkesat e MFK-së për vetëvlerësim;
- Monitorimi efektiv dhe sistematik i aktiviteteve ku raportimi aktual nuk ofron një bazë formale për menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve; dhe
- Sistemi i auditimit të brendshëm – ekziston një komunikim i dobët me menaxhmentin dhe si rezultat i kësaj, nuk ishte mbajtur asnjë takim në mes tyre për të diskutuar çështjet e ngritura nga auditimi.

### 4.1 Qeverisja e mirë

#### Përshkrimi

Procedurat e një qeverisje të mirë kanë për qëllim të konfirmojnë që menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmentit për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave të identifikuara operative dhe financiare.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 4 - Aranzhimet e Përgjithshme për Qeverisje - Prioritet i Lartë

##### E gjetura

Rishikimi i bërë kontrolleve të larta menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një kontroll të dobët mbi shpenzimet dhe të hyrat. Kjo ka ndodhur për shkak se forma e raportimeve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth dallimeve ndërmjet buxhetit dhe realizimit.

Kërkesat e MFK-së për aplikim të vetëvlerësimit dhe për menaxhim formal të rrezikut nuk janë adresuar fare sepse komuna nuk e njeh plotësisht rëndësinë e tyre si mjete për ta mbështetur menaxhimin efektiv.

Megjithëse ekziston Komiteti i Auditimit, kontributi i këtij komiteti për aranzhimet për qeverisje të mirë ka qenë minimal. Ky komitet nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet të rëndësishëm gjatë vitit 2014 për shkak të mungesës së rëndësishme që komuna i ka kushtuar këtij komiteti.

#### **Rreziku**

Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë së dobët e zvogëlojnë efikasitetin e menaxhimit operacional dhe financiar brenda në komunë dhe mund të rezultojnë në vlerë të dobët për para dhe/apo humbje të mundshme financiare. Mungesa e një Komiteti të Auditimit efektiv redukton fokusin dhe ndikimin e aktivitetit të auditimit të brendshëm si dhe redukton sigurinë që auditimi i brendshëm i ofron menaxhmentit.

#### **Rekomandimi 4**

Kryetari i komunës duhet t'i rishikojë rregullimet qeverisëse aktuale dhe kërkesat e ndërlidhura për raportim të tyre. Kërkesat e pa plotësuara duhet të zbatohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia e çështjeve të ndërlidhura, siç është raportimi i brendshëm, duhet të rishikohen në mënyrë kritike për të dokumentuar që janë zbatuar veprime efektive për të siguruar menaxhim efektiv operacional të komunës dhe arritjen e objektivave strategjike.

### **Çështja 5 - Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit - Prioritet i Mesëm**

#### **E gjetura**

Gjatë vitit 2014 komuna ka zhvilluar 128 procedura përmes kuotimit të çmimeve për furnizime me vlerë minimale (55,025€) dhe furnizime me vlerë të vogël (397,514€). Në vijim janë paraqitur dy raste ku do të mund të përdorej procedurë e hapur e prokurimit:

- Komuna kishte bërë 15 pagesa me vlera minimale në shumë 12,751€ për mirëmbajtjen e shkollave përderisa ekzistonte një kontratë (235,112€) për punë të tilla të realizuar me procedurë të hapur; dhe
- Shtatë (7) kontrata ishin lidhur përmes kuotimit të çmimeve (47,844€) për renovim, suvatim dhe ngjyrosje të objekteve. Katër prej tyre, ishin lidhur me operatorin e njejtë ekonomik.

#### **Rreziku**

Komuna nuk aplikon procedura të duhura të prokurimit. Përdorimi i procedurës së kuotimit për shpenzime që mund të realizohen me procedurë të hapur, shton rrezikun e përfitimit të ulët të vlerës për para, eliminon konkurrencën dhe mund të jetë subjekt i mashtrimit.

#### **Rekomandimi 5**

Kryetari i komunës duhet të analizojë arsyeshmërinë e një numri kaq të lartë të kuotimeve, me theks të veçantë në rastet kur për shpenzime të njejta ekzistojnë kontratë me procedurë të hapur. Kryetari duhet të forcojë kontrollet në planifikimin dhe realizimin e prokurimit duke siguruar që për shpenzimet e natyrës së njejtë do të përdoren procedurat e hapura për të arritur vlerën më të lartë për paranë e paguar.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>19,208,665</b>	<b>22,024,482</b>	<b>20,536,683</b>	<b>20,263,384</b>	<b>18,970,438</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	16,163,665	17,567,773	17,232,343	16,980,919	15,930,094
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	665,509	659,067	650,615	668,228
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	3,045,000	3,271,542	2,566,106	2,456,879	2,121,449
Donacionet e brendshme	0	72,557	0	4,500	6,560
Donacionet e jashtme	0	447,101	79,167	170,469	244,107

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,815,818€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i:

- Rritjes së grantit qeveritar në shumë 1,404,108€
- Rritjes së të hyrave vetjake të vitit 2014 në shumë 226,542€
- Bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2013 në shumë 665,510€;
- Donacioneve të brendshme në shumë 72,557€; dhe
- Donacioneve të jashtme në shumë prej 447,101€.

Në vitin 2014 komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ngjashëm me vitin paraprak. Realizimi i buxhetit është në nivel relativisht të kënaqshëm ndërsa më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>19,208,665</b>	<b>22,024,482</b>	<b>20,536,683</b>	<b>20,263,384</b>	<b>18,970,438</b>
Pagat dhe Mëditjet	10,549,983	11,998,581	11,925,237	10,482,665	10,378,157
Mallrat dhe Shërbimet	2,438,219	2,549,360	2,260,801	2,705,611	2,686,923
Shërbimet komunale	611,914	611,914	528,460	597,009	557,083
Subvencionet dhe Transferet	350,000	430,139	428,300	599,233	473,692
Investimet Kapitale	5,258,549	6,434,488	5,393,885	5,878,865	4,874,583

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale ishte rritur për 1,175,939€, ndërsa shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ishte vetëm 84% e buxhetit apo 8% më pak se vitin paraprak, e që prezenton një performancë jo të kënaqshme buxhetore. Për më tepër, shuma 146,000€ nga buxheti për investime kapitale ishte paguar për shërbime dhe 469,819€ ishin ekzekutuar sipas Nenit 39.2 të LMFP-së për obligimet e papaguara ndaj furnitorëve. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve për të bërë një planifikim të mirëfillt dhe menaxhim adekuat të kontratave. Si pasojë, disa projekte nuk kanë filluar fare, e te disa të tjera kanë ndodhur vonesa në realizimin e punëve;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje me 1,468,598€ ka ndodhur për shkak të vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave për 25%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur për 111,141€ ndërsa niveli i shpenzimeve ishte 89% e buxhetit final. Komuna nuk kishte ndërmarrur ndonjë veprim formal për menaxhimin e shkurtimeve buxhetore nga mallrat dhe shërbimet (15% me vendim qeveritar). Kjo ka rezultuar në rritje të obligimeve të papaguara në shumë 30,000€ për mallra dhe shërbime dhe rreth 70,000€ për shërbime komunale. Ky nivel i ekzekutimit të buxhetit reflekton mungesën e një planifikimi buxhetor bazuar në nevoja dhe mundësi reale të komunës; dhe
- Shuma totale e donacioneve (të brendshme dhe të jashtme) ishte 519,658€, ndërsa vetëm 15% prej tyre ishin shpenzuar. Kjo ka ndodhur për shkak të performancës së dobët të komunës për shfrytëzimin e donacioneve që ka pasur ndikim negativ në përmbushjen e planeve të komunës.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2014 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,045,000	3,271,542	3,271,418	3,003,047	2,727,094

Plani fillestar për inkasimin e të hyrave vetjake gjatë vitit 2014 ishte tejkalluar për 7%. Krahasuar me vitin paraprak komuna ka inkasuar 9% më shumë të hyra apo 20% më shumë se në vitin 2012. Rritja e të hyrave në vitin 2014 ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga taksa nga kadastri, taksa administrative, si dhe dyfishimit të të hyrave nga gjobat në trafik dhe dënimet nga gjykata. Shuma 2,72 5,087€ janë mbledhur nga komuna, ndërsa 546,331€ janë të hyra nga gjobat e trafikut dhe nga gjykata.

## Rekomandimet

---

### Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna ka treguar performancë të dobët buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale (84%). 11% e shpenzimeve përbëjnë pagesa për shërbime dhe për obligime nga vitet e kaluara, që reflekton se vetëm 73% të investimeve kapitale ishin shpenzuar gjatë vitit. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës.

Për shkak të nivelit të ulët të shfrytëzimit të të hyrave vetjake, 18% apo 711,879€ janë bartur për shpenzim në vitin 2015. Ngjashëm ka ndodhur edhe me buxhetin nga donacionet ku vetëm 15% nga 519,658 janë shpenzuar gjatë vitit 2014. Edhe kjo pasqyron një planifikim të dobët.

**Rreziku** Planifikimi dhe ekzekutimi i dobët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve të komunës dhe rezulton në mos arritjen e objektivave. Niveli i ulët i përdorimit të buxhetit mund të rezultojë në reduktimin e granteve qeveritare dhe humbjen e donacioneve në të ardhmen. Mbivlerësimi i shpenzimeve për investime kapitale shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe mund të rezultojë me modifikim të opinionit.

**Rekomandimi 6** Kryetari i komunës duhet të sigurojë monitorimin e performancës buxhetore në mënyrë sistematike dhe në baza mujore për të siguruar nivel të pritur të ekzekutimit të buxhetit dhe përdorimin efektiv të të hyrave vetjake. Të gjitha shpenzimet duhet të planifikohen dhe klasifikohen në kodet/kategoritë e duhura dhe të shpalosen drejtë në PVF-të e vitit 2015.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

### Përshkrimi

Burimet kryesore të të hyrave vetjake të komunës janë: tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, participimet, taksat për regjistrimin e automjeteve dhe taksat tjera administrative. Komuna poashtu mbledh të hyra nga gjykatat, gjobat në trafik dhe lejet për shfrytëzimin e pyjeve. për shfrytëzimin e pronës.

---

## Rekomandimet

---

### Çështja 7 -Dobësi në planifikimin, arkëtimin dhe raportimin e të hyrave - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi që e kanë përcjellur komunën në menaxhimin e arkëtimit të të hyrave vetjake. Këto dobësi janë paraqitur në vijim:

- **Tatimi në pronë** - Planifikimi për të hyra nga tatimi në pronë në vitin 2014 ishte 1,270,000€ ndërsa inkasimi ishte 1,405,213€ apo 11% më shumë se planifikimi. Kjo nuk prezenton një performancë reale pasi që shuma e planifikuar është më e ulët se ajo e faturuar (1,771,510€). Shuma e faturuar ishte 28% më e lartë se planifikimi. Ky planifikim, edhe pse pjesërisht përcaktohet nga kufijtë e qarkores buxhetore, reflekton një projeksion të dobët dhe të pabazuar për këtë lloj të të hyrave.
- **Lejet e ndërtimit** - Inkasimi nga lejet e ndërtimit ishte planifikuar 250,000€ ndërsa ishin inkasuar 267,533€ duke përfshirë edhe arkëtimet për faturat nga vitet e kaluara. Krahasuar me vitin paraprak (577,562€) inkasimi nga lejet e ndërtimit ka shënuar rënie për 115%. Komuna nuk ishte në gjendje të ofrojë ndonjë shpjegim për këtë rënie;
- **Të hyrat nga qiradhënia** - Vetëm 26,671€ apo 48% e shumës së ngarkuar nga qiradhënia (55,000€) ishin inkasuar nga komuna. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së rishikimeve efektive të këtyre të hyrave dhe menaxhmenti; dhe
- **Mbajtja e bazave dhe raportimi** - Mledhja dhe raportimi i të hyrave nga participimi në shëndetësi kryhet në mënyrë manuale edhe pse në komunë ka një program softuerik për arkëtimin e të hyrave deri në 10€. Baza e të dhënave për pagesat e participimeve në institucionet parashkollore mbahet vetëm në kopje fizike. Drejtoria për kadastër nuk bën raportime dhe barazime të rregullta të të hyrave të zyrtarja për të hyra. Biblioteka "Azem Shkreli" realizon të hyra nga antarësimi i lexuesëve, por këto të hyra nuk deponohen me kohë në bankë. Kjo ka ndodhur sepse komuna nuk ka zbatuar rregulloret për inkasimin dhe raportimin e të hyrave.

### Rreziku

Planifikimi i dobët i të hyrave ndikon në projeksionet e përgjithshme të planifikimit të buxhetit, veçanërisht në fushën e investimeve kapitale, ndërsa inkasimi i dobët i të hyrave mund të rezultojë me investime të reduktuara nga komuna. Mbajtja manuale, mungesa e raportimit dhe vonesa e deponimit të të hyrave në bankë mund të rezultojë me humbje potenciale financiare dhe mund të jetë subjekt i mashtrimit.

**Rekomandimi 7** Kryetari i komunës duhet të inicojë një analizë për arsyet e mospërputhjeve domethënëse në mes planifikimit, inkasimit dhe faturimit të të hyrave. Trendi i të hyrave gjatë viteve të kaluara duhet të merret në konsiderim, ndërsa aplikimi i kontrolleve të dobëta në aspektin e menaxhimit (bartja e të hyrave në vitin vijues) duhet të përmirësohet. Gjithashtu, kontrollet duhet të forcohen, për të siguruar që të gjitha institucionet e komunës do të inkasojnë të hyrat që parashihen me ligj dhe të njejtat do të raportohen dhe deponohen në llogarinë e komunës. Një zgjidhje e përshtatshme duhet të prezantohet deri në fund të vitit 2015.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin edhe kërkesat për t'i zvogluar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, shmangien e konfliktit të interesave dhe ofertave jo të plota dhe arritjes së vlerës për para.

Në vitin 2014 në total janë zbatuar 200 procedura të prokurimit në vlerë 4,129,666€.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 8 - Dobësi në shpenzimet me prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi gjatë shpenzimeve me prokurim. Këto kanë ndodhur për shkak të mungesës së rishikimeve efektive nga menaxhmenti dhe mos-zbatimit të rregullave të prokurimit. Rastet e identifikuara janë paraqitur në vazhdim:

- Për projektin "Asfaltimi i rrugëve Adrian Kelmendi, Qerim Begu dhe kubëzimi i rrugës Ilmi Malushi" ishte kërkuar çertifikata për posedim të bazës së asfaltit, ndërsa operatori ekonomik kishte sjellë një çertifikatë të skaduar. Komuna e kishte shpërblyer me kontratë në vlerë 48,376€;
- Për furnizim me karburante me kontratë ishte kërkuar çmimi furnizues sipas çmimit mesatar të berzës, ndërsa operatori ekonomik kishte aplikuar çmimin sipas faturës së furnizimit, plus premiumin dhe jo sipas lëvizjes së çmimit në berzë ndërkombëtare;
- Transportimi i nxënësve me nevoja të veçanta në vlerë 3,035€ ishte bërë me një marrëveshje, duke anashkaluar procedurat e prokurimit;

- Komuna kishte paguar faturën 24,809€ për projektin e bashkfinancuar me Ministrinë e Kulturës për “Ndërtimin e sallës së edukatës fizike ne shkollën e mesme Bedri Pejani në Pejë” edhe pse në faturë nuk ishin përshkruar pozicionet e punëve të kryera dhe situacioni nuk ishte nënshkruar nga organi mbikqyrës i projektit; dhe
- Komuna kishte planifikuar 30,000€ për mirmbajtje të ndriçimit publik ndërsa shpenzimet e ndodhura ishin 53,759€. Poashtu, shpenzimet e planifikuara për mirmbajtjen e varrezave ishin 40,000€, ndërsa shpenzimet e ndodhura ishin 52,844€. Pjesa e tejkualuar ishte paguar nga buxheti i projekteve tjera.

#### **Rreziku**

Shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik pa i plotësuar kriteret e tenderit apo pa kaluar përmes procedurave të prokurimit, përveç që është në kundërshtim me kërkesat ligjore mund të rezultojë me punë/furnizime jo cilësore dhe vlerë të dobët për paranë e paguar. PAGESA PËR PUNË PA NËNSHKRIM nga organi mbikqyrës, nuk konfirmon kryerjen e punimeve dhe mund të rezultojë me pagesa të parregullta. Tejkalimi i buxhetit për shpenzimet e planifikuara mund të rezultojë me ngecje apo dështim të projekteve tjera të planifikuara.

#### **Rekomandimi 8**

Kryetari i komunës duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të prokurimit gjatë vlerësimit të tenderëve dhe pranimit të punëve dhe furnizimeve për të siguruar që pagesat e bëra janë vetëm për punët/furnizimet e pranuar që plotësojnë kërkesat e cilësisë. Asnjë kontratë nuk duhet t'i ofrohet operatorëve që nuk plotësojnë kriteret e tenderit. Në anën tjetër, të gjitha shpenzimet që kërkojnë prokurim duhet të kalojnë përmes procedurave adekuate të prokurimit për të siguruar vlerën për para. Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi i nevojave bëhet bazuar në analiza adekuate për të shmangur tejkalimet e shpenzimeve të planifikuara.

## **4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit**

### **Përshkrimi**

Shpenzimet jo përmes prokurimit kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime për të cilat nuk kërkohet prokurim. Shembuj të këtyre shpenzimeve janë komunalitë, avancet për udhëtime, drekat zyrtare, shpenzimet përmes parasë së imët, një pjesë e bashkëfinancimeve etj. Janë disa aspekte të procesit të shpenzimeve jo përmes prokurimit të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive.

## Rekomandimet

---

### Çështja 9 - Pagesat për bashkëfinancim - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Komuna ka transferuar në llogari të dy organizatave IOM dhe “Rotary Club” shumën 12,000€ respektivisht 7,362€ bazuar në marrëveshje për bashkëfinancime për projektin “Participimi në projekte me komunitet, donatorë dhe ministri”. Pagesat ishin bërë paraprakisht në pajtim me marrëveshjet përderisa nuk kishte kërkesa për raportim financiar dhe të rezultateve gjatë fazës së implementimit.
- Rreziku** Pagesat paraprake të pa mbështetura me kontrata efektive mund të rezultojë me humbje financiare për komunën. Mungesa e raportimit gjatë fazës së implementimit të projekteve mund të rezultojë me mos përmbushjen e objektivave dhe potencialisht mund të konsiderohen si pagesa të parregullta.
- Rekomandimi 9** Kryetari i komunës duhet ta rishqyrtojë arsyeshmërinë e praktikave të hyrjes në kontrata dhe kryerjes së pagesave paraprake shumë kohë para fillimit të projektit. Për më tepër, marrëveshjet duhet të sigurojnë raportim adekuat të financave dhe rezultateve gjatë fazës së implementimit për të krijuar një bazë për monitorim. Raportet finale duhet të publikohen për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

#### Rekomandimet

---

### Çështja 10 - Procedurat e rekrutimit - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i procedurave të rekrutimit ka identifikuar dobësitë në vijim:
- Një konkurs i datës 29.03.2014 ishte anuluar nga inspektorati i punës dhe një ndër arsyt ishte mos plotësimi i përgjigjeve të testit me gojë të kandidatëve. Më 15.09.2014 komuna kishte rishpallur këtë konkurs për pesë (5) doktorë të stomatologjisë. Kemi identifikuar se testet me gojë të kandidatëve përsëri nuk ishin plotësuar. Për më tepër, me këtë konkurs ishin pranuar gjashtë (6) kandidatë. Kjo ka ndodhur sepse komuna nuk ka zbatuar rregullore për rekrutim; dhe



- Dy konkurse për drejtor të institucioneve shkollore dhe tri konkurse për mësimdhënës ishin zhvilluar në mungesë të listës së komisionit zgjedhor , listës së kandidatëve që kanë konkurruar, listës së ngushtë të kandidatëve, dhe listës kualifikuese për të dërguar te Kryetari i komunës për miratim. Edhe ky rast reflekton shkelje të rregulloreve për rekrutim.

**Rreziku** Shkeljet e procedurave të rekrutimit thyejnë parimin e trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe mund të rezultojnë me pranimin e stafit jo kompetent dhe shërbime jo cilësore ndaj qytetarëve.

**Rekomandimi 10** Kryetari i komunës duhet t'i anaizojë shkaqet pse nuk janë rrespektuar procedurat e rekrutimit në rastet e identifikuar dhe të sigurojë që këto do të mbeten raste të izoluara. Kontrollat gjatë rekrutimit duhet të forcohen dhe procesi duhet të monitorohet nga Kryetari për të siguruar që pranohen vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e parapara.

#### Çështja 11 - Paga të parregullta- Prioritet i Lartë

**E gjetura** Në mars të vitit 2014 Kryetari i komunës kishte emëruar një drejtor të QKMF-së pa konkurs dhe pa kontratë të punës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil me 20.11.2014 kishte marrë vendim për anulim të rekrutimit të këtij drejtori duke e obliguar komunën që brenda afatit 15 ditor ta zbatojë vendimin. Ky vendim nuk ishte zbatuar, dhe paga ishte paguar deri në muajin Dhjetor 2014. Kjo ka ndodhur për shkak që komuna nuk ka zbatuar rregullat e rekrutimit.

Në pagat e stafit arsimor për mars/gusht 2014 janë përfshirë edhe paga të pa paguara nga vitet e kaluara në shumë prej 10,447€ për orët e mbajtura për mësimin e rregullt, mësimin jo formal dhe punë shtesë. Komuna nuk ishte në gjendje të ofrojë dëshmi të mjaftueshme mbi rregullsinë e këtyre pagave për vitet e kaluara. Kjo ka ndodhur për shkak të rishikimeve të dobëta të menaxhmentit ndaj shpenzimeve për paga.

**Rreziku** Emërimi dhe pagesa e drejtorit pa konkurs dhe pa kontratë, si dhe pagesa e pagave nga vitet e kaluara pa dëshmi të mjaftueshme, nuk konfirmojnë bazën e mjaftueshme për rregullsinë e pagesave. Si të tilla, këto pagesa mund të rezultojnë si të parregullta dhe shkaktojnë humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi 11** Kryetari i komunës duhet të sigurojë rishikimin e vendimit për emërim të drejtorit të QKMF-së dhe të sigurojë që të gjitha rekrutimet bëhen në pajtim të plotë me kërkesat ligjore. Kontrollat lidhur me pagesën e stafit arsimor duhet të forcohet për të siguruar që të gjitha pagesat janë të mbështetura me dëshmi të mjaftueshme në përputhje me rregullat financiare.

#### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

##### Përshkrimi

Llojet kryesore të subvencioneve që ndahen nga komuna janë bursa për studentë dhe nxënës, subvencione për sport, ndihmë rasteve sociale, subvencione për bujqësi, etj. Komuna ka një rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve, në bazë të të cilës përcaktohen kriteret për ndarjen e tyre.

##### Rekomandimet

---

#### Çështja 12 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi lidhur me ndarjen e subvencioneve të cilat kanë ndodhur për shkak të mungesës së rishikimeve efektive dhe moszbatimit të rregullres së brendshme dhe rregullave financiare. Këto dobësi janë paraqitur në vijim::

- Komuna kishte subvencionuar KF "Peja" në shumë 7,000€ pa ndonjë projekt/plan të detajuar mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve. Për më tepër, përfituesi nuk kishte raportuar në komunë për mënyrën dhe qëllimin e shpenzimeve e këtyre fondeve;
- Një rast i ngjashëm kishte ndodhë edhe me një subvencion të dhënë në shumën prej 6,000€ për fshatin Jabllanicë e Madhe për ndërtimin e rrethojave të varrezave të fshatit; dhe
- Rregullorja e brendshme përcakton që një përfitues mund të merr subvencione vetëm një herë gjatë vitit. Komuna kishte subvencionuar për disa herë gjatë vitit KF "Besa" në shumë totale prej 15,000€ dhe OJQ "Qendra Rinore Peja" në shumë totale prej 21,608€. Për më tepër, koordinatore dhe nënshkruese e marrëveshjes nga ana e OJQ-së "Qendra Rinore Peja" ishte një zyrtarë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Rreziku** Mungesa e projekteve/planeve për financimin e aktiviteteve dhe mungesa e raportimit të shpenzimeve nga mjetet e përfituara si subvencione, mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta dhe mos arritjen e objektivave të synuara. Nënshkrimi i marrëveshjes për subvencionim nga zyrtarja e komunës paraqet konflikt potencial të interesit.

**Rekomandimi 12** Kryetari i komunës duhet të sigurojë një rishikim për ndarjen e subvencioneve dhe t'i forcojë ato për të siguruar që të gjitha shpenzimet për subvencione janë në pajtim me rregulloren e brendshme dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave të komunës. Të gjithë përfituesit duhet të bëjnë raportime kthyesë në komunë për të siguruar vlerën për parandë dhe për të shmangur mundësinë e



mashtimeve. Kryetari duhet të sigurojë se rastet e mundshme të konfliktit të interesit do të shmangen dhe nuk do të përsëriten në të ardhmen.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Menaxhimi i pasurive në komunën është shoqëruar me dobësi të vazhdueshme. Komisioni për inventarizim të pasurisë ishte formuar me vonesë dhe si rezultat deri në fund të auditimit tonë nuk kishte përfunduar punën.

Ne kemi identifikuar si rrezik signifikant plotësinë e pasurive të komunës dhe si i tillë është trajtuar në kapitullin 2.2 (shih çështjen 1).

### 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmëve

#### Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 13 - Rritje sistematike e llogarive të arkëtueshme - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Shuma e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2014 arrin shifrën 15,039,448€, prej të cilave pjesa më e madhe është nga tatimi në pronë (8,473,170€) dhe licenca tjera afariste (6,457,680€), pastaj qiraja (11,920€), participimet nga institucionet parashkollore (8,785€), dhe shfrytëzimi i panove për reklama (83,348€). Rritja e vazhdueshme e këtyre llogarive ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka arritur të vendos mekanizma efektiv për inkasimin e tyre. Për më tepër, komuna ende nuk ka një strategji mbi veprimet që duhet të ndërmerren për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

**Rreziku** Rritja e llogarive të arkëtueshme zvogëlon mundësinë e komunës për të financuar projektet nga të hyrat vetjake dhe mund t'i nxisë debitorët tjerë të mos i paguajnë obligimet e tyre ndaj komunës.

**Rekomandimi 13** Kryetari i komunës duhet të iniciojë analizimin e arsyeve të nivelit të lartë të të arkëtueshmeve dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të prezantohen për të mundësuar mbledhjen e të arkëtueshmeve historike, përfshirë edhe veprimet ligjore.

---

### 4.5.3 Trajtimi i borxheve

#### Përshkrim

Borxhet e komunës paraqesin obligimet që komuna kryesisht ka ndaj furnitorëve por edhe ndaj punëtorëve të vet. Edhe në komunën e Pejës ekziston një trend i rritjes së borxheve vit pas viti, e që reflekton një menaxhim jo të duhur të aktiviteteve buxhetore.

Pasqyra e borxheve të komunës për 2014 tregon obligime të komunës në shumë 609,000€. Kjo shumë përbëhet nga obligimet për mallra dhe shërbime (409,240€), shpenzime komunale (180,691€) dhe investime kapitale (18,879€).

Edhe këtë vit komuna ka hyrë në obligime të papaguara për shkak të mungesës së menaxhimit efektiv të shkurtimeve buxhetore për 15% për mallra dhe shërbime (shih pjesën 4.2).

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 14 - Nivel i lartë i borxheve të komunës - Prioritet i Lartë

**Rreziku** Komuna nuk ka arritur të vendos rishikime efektive për të mbajtur nën kontroll nivelin e borxheve. Si rezultat borxhet e komunës kanë shënuar rritje të vazhdueshme dhe në vitin 2014 shuma 469,819€ ishte ekzekutuar sipas Nenit 39.2 të LMFPP-së për obligimet e papaguara ndaj furnitorëve. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore ngase komuna posedon edhe detyrime kontingjente në shumë 921,860€ që mund të shndërrohen në obligime përfundimtare, duke rënduar edhe më tej situatën buxhetore të komunës.

**Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe ngritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti i komunës të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore (siç ka ndodhur në vitin 2014). Një situatë e tillë mund ta shpie komunën në një gjendje të vështirë financiare që mund të ketë pasojë mosrealizimin e projekteve dhe çrregullime tjera në financimin e veprimtarive kryesore.

**Rekomandimi 14** Kryetari i komunës duhet t'i forcojë kontrollet menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Për trajtimin e borxheve të akumuluar, Kryetari duhet të paraqes një plan ku parashihen veprime konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të komunës. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i komunës.

## 4.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) për vitin 2014 kishte planifikuar dymbëdhjetë auditime dhe kishte përbushur planin e saj. Fushat e mbuluara nga auditimi i brendshëm ishin: 1) Procesi i prokurimit (për vitin 2013); 2) Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve (për vitin 2013); 3) Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve, rrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve për dhënien e lejeve të ndërtimit (për vitin 2012/2013); 4) Të hyrat dhe shpenzimet në Drejtorinë e Kadastrit (për vitin 2013); 5) Të hyrat dhe shpenzimet (për vitin 2013/tremujorin e parë 2014); 6) Shpenzimet e Zyres së Kryetarit (për vitin 2013); 7) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural (për vitin 2013/gjashtmuajorin e parë 2014); 8) Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve, rrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve për taksa, tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale (për vitin 2013/gjashtmuajorin e parë 2014); 9) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë për kulturë, rini dhe sport (për vitin 2013/janar-gusht 2014); 10) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë për Arsim (për vitin 2013/janar-qershor 2014); 11) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë për shëndetësi (janar-tetor 2014); dhe 12) Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve (për vitin 2014).

Gjatë rishikimit të punës së NjAB, ne kemi vlerësuar se nuk mund të mbështetemi në punën e auditimit të brendshëm për qëllime të reduktimit të punës tonë audituese. Kjo për arsye se objektivat, qasja e testimit si dhe mbulueshmëria e auditimit nuk na përputhen në tërësi.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 15 - Dobësitë në auditimin e brendshëm - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar që ekzistojnë disa dobësi në sistemin e auditimit të brendshëm. Këto dobësi janë paraqitur në vijim:

- Vetëm një pjesë e vogël e auditimeve ka mbuluar vitin aktual 2014;
- Menaxhmenti nuk përgatit plane për implementimin e rekomandimeve të NjAB. Si rezultat vetëm gjysma nga 64 rekomandimet e dhëna ishin adresuar; dhe
- Ekziston komunikim i dobët ndërmjet NjAB-së dhe menaxhmentit. Si pasojë, asnjë takim për komunikimin dhe diskutimin e dobësive të identifikuara gjatë auditimit nuk ishte mbajtur.

- Komiteti i Auditimit (KA) ka mbajtur takimet e rregullta tremujore, ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të NjAB dhe ka kërkuar nga menaxhmenti që të implementoj rekomandimet e dhëna nga NjAB.

**E gjetura**

Mungesa e njohjes së rolit dhe rëndësisë së NjAB do të rezultojë me përfitim të kufizuar të menaxhmentit në marrjen e sigurisë për mjedisin e kontrollit të brendshëm. Mungesa e planeve të veprimit do të rezultojë me vazhdim të dobësive në sistemet kyçe financiare dhe operative të komunës duke shkaktuar humbje potenciale financiare dhe vlerë të dobtë për para.

**Rekomandimi 15**

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që KA merr një rol pro-aktiv në mënyrë që të arrihet përfitimi maksimal nga sistemi i auditimit të brendshëm. KA duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e NjAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës. Kryetari duhet të vendosë komunikim të rregullt me NjAB-në për të parandaluar gabimet dhe parregullsitë në sistemet financiare dhe operative të komunës.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori

nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

#### Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një

paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryetari duhet të identifikoj veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësoj një prezantim të drejtë dhe të saktë të pasurive në vitin 2014.			Nuk është adresuar
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet nga Kryetari në baza mujore.		Pjesërisht	
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) Çështja 3 – Tatim në Pronë	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e një plani strategjik në lidhje me mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe menaxhimin e këtij procesi. Një vlerësim paraprak duhet të bëhet bazuar në kompleksitetin e njohur të operacioneve ekzistuese dhe gjetjen e formës për rritjen e nivelit të mbledhjes së tatimit në pronë			Nuk është adresuar
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) Çështja 4 – Mos harmonizimi i të hyrave nga Departamentet komunale	Për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e të hyrave, Kryetari i komunës duhet të siguroj se në baza të rregullta bëhen barazimet e të hyrave nga departamentet komunale me zyrtarin e të hyrave		Pjesërisht	



4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) 5 - Taksa e veprimtarisë së Bizneseve	Kryetari duhet sa ma parë të planifikojë se si t'i trajtojë llogaritë e arkëtueshme nga taksa e veprimtarisë të grumbulluara gjatë viteve.	Po		
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) Çështja 6 - Të hyrat nga arsimi i mesëm	Ne gjatë periudhës së ndërmjetme kemi këshilluar menaxhmentin që të ndërpres praktikën e pranimin të parave të gatshme mbi 10€ (jashtë llogarisë bankare). Në fazën finale jemi siguruar se veç ka filluar implementimi i këshillës së dhënë. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të vazhdoj me praktikën e filluar	Po		
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) Çështja 7 - Të hyrat nga Participi në shëndetësi	Kryetari duhet sa më parë të ndërmerr masa që vlerat mbi 10€ të paguhen në llogarinë bankare të komunës që është autorizuar nga Drejtori i Thesarit	Po		
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) Çështja 8 - Të hyrat nga dhënia e objekteve me qera	Kryetari duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, i cili do të shqyrtohej në mënyrë të rregullt			Nuk është adresuar
4.4 Shpenzimet (prokurimet) Çështja 9 - Dobësitë sistematike në prokurim	Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në këto raste dhe të sigurojë se implementohen kontrole të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten.		Pjesërisht	
4.4 Shpenzimet (prokurimet) Çështja 10 - Dobësi të kontroleve në zbatimin e kontratave	Kryetari i komunës duhet të siguroj një sistem efektiv të kontrollit në gjithë procesin e prokurimit deri te përmbushja e plotë e kontratave. Duhet ndërmerren veprime proaktive për parandalimin e devijimeve nga kushtet e kontratës si në pranimin e mallit ashtu edhe në		Pjesërisht	

	pagesën e çmimeve për to			
4.4 Shpenzimet (prokurimet) Çështja 11- Dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare	Kryetari duhet sa ma parë të vendos kontrolle efektive në këtë fushë, në mënyrë që automjetet të shfrytëzohen pasi të plotësohet dhe aprovohet kërkesa për shërbime të vozitjes.	Po		
4.4.3 Kompensimet ( paga dhe mëditje) Çështja 12- Dosjet e personelit jo komplete	Kryetari duhet të sigurojë që departamenti i burimeve njerëzore azhurnon në baza të rregullta të gjitha dosjet e personelit, përfshirë edhe kontratat e punës.		Pjesërisht	
4.4.4 Subvencionet dhe Transferet Çështja 13 - Vendime për subvencione pa fonde	Kryetari duhet ta ndërpres këtë dukuri dhe në të ardhmen mos të marrë vendime pa pasur buxhet të aprovuar. Subvencioni duhet dhënë vetëm kur ka fonde dhe në pajtim me rregulloren për subvencione.	Po		
4.4.4 Subvencionet dhe Transferet Çështja 14 - Subvencionimi i entiteteve publike	Kryetari duhet të sigurohet se janë zbatuar marrëveshjet me përfituesit duke i obliguar ata të raportojnë në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Të zbatohet rregullorja komunale për subvencione si dhe Komuna të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat e përcaktuara.			Nuk është implementuar
4.5 Pasurit dhe obligimet Çështja 15 - Regjistrimi i pasurive	Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që mundësojnë regjistrimin e menjëhershëm të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës në pajtim me kërkesat e UA dhe raportimin e saktë dhe të plotë të pasurive. Po ashtu duhet kryhet inventarizimi i pasurive në fund te vitit me qëllim që të vërtetohet ekzistenca fizike e gjithë pasurisë në ditën e inventarizimit.			Nuk është implementuar
4.5.2 Trajtimi i të arketueshmeve	Kryetari duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu			Nuk është implementuar

Çështja 16 – Rritja e të arkëtueshmeve	edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumëve domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative.			
4.6 Trajtimi i borxheve Çështja 17 - Hyrja në detyrime përtej fondeve	Kryetari duhet të siguroj që komuna të mos futet në obligime duke e tejkaluar buxhetin dhe duke e rrezikuar buxhetin e vitit të ardhshëm.	Po		
4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm Çështja 18 – Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se plani i auditimit për njësinë e auditimit të brendshëm të përfshij proceset/aktivitetet e vitit aktual në mënyrë që të ndihmoj menaxhmentin në marrjen e vendimeve me kohë dhe të parandalojë parregullsitë dhe gabimet eventuale..			Nuk është implementuar